

Hapet thirrja për bursa për Studentët dhe Stafin Akademik për mësimdhënie të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin Aegean, Athinë, Greqi për semestrin e II-të të vitit akademik 2016-2017

Në kuadër të Programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e nivelit Bachelor viti III-të dhe stafin akademik për mësimdhënie të Universitetit të Tiranës në Universitetin Aegean, Athinë, Greqi për semestrin e II-të të vitit akademik 2016-2017.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për shkrimin/hulumtimin e tezës së Bachelor-it;
- Mësimdhënie për stafin akademik;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor viti i III-të;

Kohëzagjatja e bursave:

- Bachelor (3-4 muaj);
- 7 ditë duke përfshirë dhe 2 ditët e udhëtimit vetëm për stafin akademik;

Fushat e studimit:

- Financë dhe Administrim;

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti Aegean, klikoni në adresën:

http://erasmus.aegean.gr/en_GB/agean_erasmus_mobility/agean-erasmus-student-mobility/

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor 800 Euro në muaj për studentët;
- Kompensimin ditor 140 Euro për stafin akademik për mësimdhënie;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor viti III:**

- CV (në gjuhën angleze/greke);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/greke në vartësi të programit të studimit);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/greke në vartësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj B2 (Anglisht/Gregisht në vartësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement;

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti Prof. Assoc. Ervin Demo dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze/greke);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/greke);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze/greke (niveli B2);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

**Mobility Plan është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

Afati për aplikim: **02 Mars 2017**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt: “Aplikim për bursë në Universitetin Aegean, emrin dhe mbiemrin tuaj”.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!